




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-18-5829-2-3-6/C94
14 Nr. 744/18
Dt. 31.08.2018

KONTRATË SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. **NNP “ Arhiko Ing “** me seli në **Prishtinë**, me **NRB : 70353660** e **Nr. Fiskal: 600244537**, të cilën e përfaqëson **z. Shefshet Morina**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I SHËRBIMIT**,

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: :

Rregullimi i dy varrezave të dëshmorëve në fsh. Bletaj , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	8	58	2	9	2	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	8	1	3	8	2	3	6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Rregullimi i dy varrezave të dëshmorëve në fsh. Bletaj, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se **7 ditë pune pas datës së fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve dhe / ose Punëve.**

1.3 Vendi i dërgimit – rregullimit të varrezave dhe ekzekutimit të shërbimeve do të jetë : **Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në fsh. Bletaj.**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3.227,68€ (tremijdyqindnjëzeteshtat/68 Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës **pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Komisioni i Pranimit në Raportin e Pranimit.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e **shërbimeve dhe / ose punëve** duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **shërbimeve dhe / ose punëve.**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **shërbimeve dhe / ose punëve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrësinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të

çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);



(d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
NNP "Arhiko Ing" – Prishtinë

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e
Vushtrrisë

Emri:	Shefshet Morina	Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	31.08.2018	Data:	31.08.2018
Vula:		Vula:	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G


Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%-8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi DDP në €	Totali në €
1	Gërmimi i shtresës së dheut në trashësi mesatare $t=10.0$ cm' për hapësirën ku parashihet rregullimi i varrezave, bartja e dheut deri në deponi në distancë më së largu $L=3000$ m'. Materiali i gërmuar largohet në deponi legale, gërmimi duhet të kryhet konformë rregullave teknike të ndërtimit.	m ²	72.00	3.00	216.00
2	Furnizimi dhe montimi i kubzave nga betoni me dimensione 26x16x8cm. Shtresa e sipërme me kende jo te perthyera duhet te jete ne perberje nga rera e kuarcit, granitit dhe diabazit (ne raport te % se perberjes varesisht prej dizajnit te perzgjedhur me raport 50/30/20) e zallosur dhe impregnuar me trashesi sipas standardeve duke iu referuar fraksionit maksimal te reres per shtresen e perdorur. Kubzat duhet te plotesojn kushtet e soliditetit ne qarje (TSS>5) dhe abrazion sipas standardit ,poashtu ne dukje vizuale 0 % thithje te ujit dhe 0 % reagim ndaj acideve. Per produktin duhet te prezantohet qertifika CE (certificate of conformity) nga ana e prodhuesit. Para venies ne pune te deshmohen mostra, atestet, dizajni dhe shqyrtimi i parametrave te potencuar vizual. duke përfshir edhe zgjerimet dhe kyqjet në trotuar.	m ²	15.00	20.00	300.00
3	Furnizimi dhe montimi i skajoreve kufizuese te parterit C40/45 me dim. 8x24x100cm. Skajoret duhet te jene te dhembezuara ne lidhjet ndermjet tyre (pa fug-me dhemb), poashtu shtresa e sipërme e ekspozuar te jete nga rera e kuarcit. Paraprakisht te deshmohen atestet per to te cilat deshmojn plotesimin e kerkesave teknike sipas standardeve. Para venies ne pune te deshmohen mostra, atestet, dizajni dhe shqyrtimi i parametrave te potencuar vizual.	m'	11.00	6.00	66.00
4	Betonimi i pllakave dhe mureve me material nga betoni i armuar me rrjetë, trashësia e pllakës $t=15.0$ cm sipas detalit ne projekt, dimensionet e varrit janë 2.3 X 1.20 m. dhe pllakws pwrreth varrezave	m ³	5.50	100.00	550.00



Numri i prokurimit: VU644-18-5829-2-3-6 apo nr. i brendshem:64418-138-536 Titulli: Rregullimi i dy varrezave të dëshmorëve në fshatin Bletçjë

5	Furnizimi dhe punimi i mureve me gur të gdhendur me trashësi t=5.0 cm nga brenda me beton dhe nga jashtë me gur të gdhendur dekorativ, në pozicion parashihet edhe betonimi i mureve sipas detalit, dim d= 2.10 m h=0.30cm dhe dim d=1.1 m, h=0.30 cm.	m ²	6.00	60.00	360.00
6	Furnizimi, transporti dhe mbushja e hapësirës me zhavor te fraksionit 0-32 mm. Sipas detalit te paraqitur ne projekt.	m ³	4.64	12.00	55.68
7	Furnizimi dhe punimi i pllakës së mermerit me niansë të hirtë, me trashësi t=5.0 cm, nga brenda me beton dhe nga jashtë me pllakë mermeri, mbi murin me gurë të gdhendur.	m ²	4.00	100.00	400.00
8	Furnizimi dhe punimi i pllakës së mermerit me niansë të kuq remtë, me trashësi t=5.0 cm, nga brenda me beton dhe nga jashtë me pllakë mermeri.	m ²	4.80	100.00	480.00
9	Furnizimi dhe montimi i pllakes nga materiali mermer me trashësi te pllakes t=5.0 cm per shkrimin e emrave, në formë trekëndëshi këndrejtë, në pozicion parashihet edhe shënimi i emrit në të dy anët e pllakës. vërejtje: punëkryesi duhet të ketë parasysh se emri, (emri i prindit), mbiemri, data-viti lindjes, data-viti vdekjes dhe figura e portretit duhet të shenohen ne menyren standarte të Gravuar,dhe vendosjen e dy shtizave tv flamurit nga materjali i rostfajit me dimension h=0,50m, d=1,5cm e ankeruare ne pllaken e mermerit . Numri i varrezave 2 cope.	m ²	2.50	320.00	800.00
TOTALI I PËRGJITHSHEM:					3,227.68

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	NNP Arhiko.ing
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Shefshet Morina
NËNSHKRIMI:	
DATA:	16.08.2018
VULA:	